



Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, nxjerrë:

VENDIM SHPJEGUES PUBLIK NR. 03/2014
LINDJA E DETYRIMEVE TATIMORE PËR TVSH MBI MALLRAT E VENDOSURA NË
ARANZHIMET E DOGANËS, SI: DEPOT DOGANORE

QËLLIMI

Qëllimi i këtij Vendimi Shpjegues Publik është të sqaroj detyrimet tatimore, respektivisht mënyrën e deklarimit dhe pagesës së Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSh) për mallrat e vendosura në aranzhimet e Doganës, si: Depot Doganore.

PËRKUFIZIMET

Për qëllimin e këtij Vendimi Shpjegues Publik, definicionet në vazhdim kanë këtë kuptim:

Dokument Unik Doganor - dokumenti që ka formën e përcaktuar me Legjislacion Doganor, i cili shfrytëzohet brenda strukturës së tregtisë së mallrave me shtetet e treta duke përfshirë Procedurat e Doganës të lidhura me këtë tregti.

Procedura doganore, aranzhimet doganore, depot doganore, dhe terminologjia tjetër doganore, si p.sh zonat e lira, deponimi i përkohshëm, regjimi i pezullimit, përpunimi i brendshëm dhe i jashtëm, ri importimi, transporti ndërkombëtar dhe të tjera, e kanë kuptimin siç është përcaktuar nga Legjislacioni Doganor në fuqi.

Importimi i mallit përmes procedurës së deponimit doganor – kjo nënkupton hyrjen e mallit në depo doganore, me qëllim që të përfillojë nga shtyrja/prolongimi i detyrimeve doganore nga momenti i hyrjes deri në momentin e shitjes së atyre mallrave në vend. Në momentin e shitjes i kryen detyrimet doganore, në rast se këto mallra do të ri-eksportohen atëherë nuk ngarkohen me ndonjë detyrim doganor. Për të siguruar pagesën e detyrimeve doganore duhet të ofrohet mbulueshmëri përmes garancionit bankar, që shuma e garancionit duhet të jetë e barabartë me shumën e detyrimeve të atij malli. Regjimi doganor i hyrjes së mallit me këtë procedurë është IM7 – kodi i procedurave 71 00. Që të realizohet importimi përmes kësaj procedure duhet të ketë paraprakisht autorizim që lëshon Dogana.

BAZA LIGJORE

Neni 21, Ligji Nr. 03/L-146 për TVSh - Vendi i importimit të mallrave

1. Rregulla e përgjithshme:

Vendi i importimit të mallrave duhet të jetë ai vend ku janë vendosur mallrat kur të hyjnë në Kosovë.

2. Derogimet:

2.1. Përmes derogimeve nga paragrafi 1 i këtij neni, ku në hyrje në Kosovë, mallrat të cilat nuk janë në qarkullim të lirë vendosen nën njërin nga aranzhimet e Doganës si: depot doganore, aranzhimet e ngjashme

